

UDHËZIM
Nr.820, datë 15.11.2006

PËR RASTET E SHITJES, TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE
TË LICENCUARA TË LOJËRAVE TË FATIT DHE KAZINOVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 30/2 të ligjit nr.9567, datë 19.6.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

UDHËZON:

Shoqëritë e licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, kazinove, përpara se të transferojnë, shesin, të lënë peng dhe çdo forme tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, duhet të marrin miratimin paraprak nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

I. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit të paraqesin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për shitjen e aksioneve të tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për shitjen e aksioneve të shoqërisë, transferimin, apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.

2. Dokumentin që shoqëria nuk është në proces likuidimi apo falimentimi.

3. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.

4. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shtetit.

II. Subjektet që do të blejnë aksionet e shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit të paraqesin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vendimin e regjistrimit në gjykatë si person juridik me objekt veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, aktin e themelimit dhe statusin e shoqërisë.

2. Deklaratat e burimit të kapitalit, shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

III. Shoqëritë e licencuara për ushtrim veprimtarie për kazino, për shitjen e aksioneve, transferimit, lënies peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, të paraqesin në Komitetin e Lojërave të Fatit këto dokumente:

1. Kërkesë për shitjen e aksioneve të shoqërisë, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.

2. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.

3. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shtetit.

IV. Subjekti që do të blejë aksionet e shoqërisë me veprimtari kazino apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve, duhet të paraqesë në Komitetin e Lojërave të Fatit këto dokumente:

1. Dokumentet, origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se ai është i organizuar në formë shoqërisë apo grupime shoqërisë, me objekt veprimtarie në fushën e kazinove, si dhe aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

2. Dokument që shoqëria nuk është në proces likuidimi, falimentimi a ndonjë proces të ngjashëm në vendin ku kanë selinë qendrore, apo në vende të tjera ku ushtron veprimtarinë.

3. Një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit ku ato kanë selinë qendrore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i shtetit ku kanë selinë qendrore apo të vendeve të tjera ku ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kazinove.

4. Deklaratat për burimin e kapitalit dhe të shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove në vendin tonë, madhësinë e kapitalit të paktën në të njëjtin nivel me shoqërinë, e cila ka fituar të drejtën e lejes për veprimtari kazinoje.

5. Vërtetim nga organet përkatëse për detyrimet e natyrës fiskale apo të natyrave të ngjashme

kundrejt shtetit të tyre apo shteteve të tjera ku ato ushtrojnë veprimtarinë si për shoqërinë, edhe për çdo subjekt në rast grupimi.

6. Përvoja e subjektit në fushën e kazinove apo e lojërave të fatit në nivel të krahasueshëm me shoqërinë, e cila ka fituar të drejtën e lejes për veprimtari kazinoje.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Genc Ruli